REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

*JANAR, 2013*

# Raporti Mujor

## Janar, 2013

Kontakt:
Telefon: ++355 (4) 228 1009
e-mail: elami@minfin.gov.al

www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE........................................................................2

ZHVILLIMET EKONOMIKE..................................................................3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 8
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL ............................................................................ 10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11

ANEKSI STATISTIKOR ...................................................................... 12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Janar 2013 arriti në 115.21 përqind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Janar ishte 2.7 përqind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vëndase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Janar 2013 ishte 104.96 lekë për dollarë dhe 139.49 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Janar shënuan kuotat 5.07 për ato 12-Mujore, 4.20 për 6 Mujoret dhe 3.56 perqind për depozitat 3 Mujore dhe 2.75 për depozitat 1 Mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 9.26 përqind për huatë 12 mujore dhe 9.80 për ato 6 mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,113.3 miliardë lekë në muajin Janar, duke shënuar një rritje prej rreth 4.9 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për nëntëmuajt e parë të vitit 2012 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej 100.4 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar 2013 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 0.2 miliardë lekë;
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës Janar 2013, arritën në rreth 27.7 miliardë lekë, ose rreth 95 përqind e planit për periudhën;
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 27.9 miliardë lekë, ose rreth 94 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën;

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Janar 2013 pësoi një rritje prej 1.0 përqind krahasuar me muajin Dhjetor‘12, kur ky indeks shënonte një rritje 0.9 përqind, krahasuar me muajin paraardhës ndërsa gjatë muajit Nëntor’12 ky indeks ishte 0.2 përqind më i lartë se muaji Tetor’12. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin +2.7 përqind, +2.4 përqind dhe +2.5 përqind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit Janar u konstatua në grupin “Veshje dhe Këpucë” me 3.1 përqind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte minimale mbi normën e inflacionit (rreth -0.1 pikë përqindje).

Graf - 1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Janar arriti në 2.7 përqind duke qëndruar brënda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2012 dhe 2013 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *2012* | 1.6 | 0.6 | 1.0 | 1.6 | 1.9 | 2.2 |
| *2013* | 2.7 | | | | | |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| *2012* | 2.7 | 2.8 | 2.6 | 2.4 | 2.5 | 2.4 |
| *2013* | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Janar 2013, arriti në 139.49 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie të lehtë me -0.16 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Janar një euro u këmbye me 139.58 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Janar 2013, arriti në 104.96 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej -1.51 përqind kundrejt muajit Dhjetor‘12.

Graf - 2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Janar'13*

Në fund të muajit Janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 103.00 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Janar të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 2.00 përqind, dhe është vlerësuar kundrejt monedhës europiane, Euro (mesatarisht), me 0.85 përqind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.752 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat (%)*

Gjatë muajit Janar 2013, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.07 përqind, duke shënuar një rënie me 0.1 pikë përqind krahasuar me muajin Dhjetor. Rënie për këtë muaj kanë pësuar depozitat me afatet e maturimit 1 mujore me 0.31 pikë përqind krahasuar me muajin paraardhës, ato me afat 3 mujor me 0.22 pikë përqind si dhe ato 6 mujore me 0.1 pikë përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6, 3 dhe 1-mujore.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Janar pësoi një rënie me 1.32 pikë përqindje, duke arritur në 9.26 përqind nga 10.58 përqind që ishte në muajin Dhjetor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rënie me 0.54 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Janar arriti në 9.80 përqind.

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Janar 2013, për bonot me maturim 12 dhe 6 mujore ishin përkatësisht 6.56 përqind, 6.08 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje e lehtë në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 – mujore dhe 6-mujore me respektivisht 0.19 dhe 0.43 pikë përqindje.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Shtator 2012 regjistroi nje suficit të përgjithshëm prej 100.4 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 671.0 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Janar'12 - Shtator'12 rezultoi: *(i)* bilanci tregtar -1481.4 mln euro, *(ii)* shërbime neto 167.30 mln euro, *(iii)* të ardhura neto 8.7 mln euro, (iv) transferta neto 634.4 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

Graf - 5




*Bilanci i Pagesave 3-M III 2012*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Graf - 6




*Llogaria Korente 3-M III 2012*

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Graf - 7




*Ecuria e M.V.N. te sistemit në Janar'12- Janar'13*

Graf-8




Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Janar 2013, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 63,857.4 milionë lekë krahasuar me Janarin e vitit 2012. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 4,164.9 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 59,000.0 milionë lekë. Në muajin Janar'13 sistemi bankar rezulton me një rënie prej 5,725.7 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Dhjetor'12, rënie e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 6972.9 milionë lekë, ndërsa rritja e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1,247.2 milionë lekë e zvogëloi disi këtë rënie.

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Janar 2013 arriti në 551.4 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fund vitin 2012 shënoi vlerën 3.3 miliardë lekë, me një rënie prej rreth 0.6 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 61.47 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 339.0 miliardë lekë. Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 26.9 përqind.

## 7. Oferta e Parasë

Graf-9




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Janar ka shënuar një rënie krahasuar me muajin paraardhës Dhjetor 2012. Kjo ofertë arriti në rreth 1,113.3 miliardë lekë në fund të muajit Janar'13 duke shënuar një rënie prej 10.1 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin Dhjetor'12. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 4.9 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Graf-10




*Raporti i Depozitave ndaj M3*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 22.2 miliardë lekë në krahasim me muajin Janar 2012.

Depozitat në valutë gjatë muajit Janar'13, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 87.16 përqind të depozitave totale në valutë.

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Janar 2013, zëri "Sektorë të tjerë rezident", zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 88.5 përqind, ndjekur nga "korporata të tjera jofinanciare", me rreth 8.9 përqind dhe nga "korporata publike jofinanciare", me 1.4 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" dhe "korporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 87.16 përqind dhe rreth 10.49 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave totale me rreth 88.64 përqind e totalit (në lekë).

Graf - 11




**Përberja e depozitave Janar '13**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezident" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 823.1 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 928.6 miliardë lekë në muajin Janar 2013. Ata ndiqen nga "korporata të tjera jofinanciare" (79.63 miliardë), "korporatat të tjera jofinanciare publike" (13.9 miliardë) dhe "korporata të tjera financiare" (10.7 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 1.2 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Janar 2013, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 2.14 miliardë lekë, si rezultat i rënies së depozitave në valutë me rreth 1.02 miliardë dhe e rënies se depozitave në lekë me rreth 1.12 milliardë lek.

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar 2013 janë mbledhur rreth 27.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 27.9 miliardë lekë, që përfshijnë 24 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 3.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 33 % financim i brëndshëm, dhe 67 % financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 95 % të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 94 % të ketij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 99.6 % e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 89 % të tij.

Graf - 12




*Treguesit Fiskal, Janar 2013*

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 17 miliardë lekë (ose rreth 6.7 % e Të Ardhurave të planifikuara vjetore), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 862 milionë lekë (7.2 % e planifikimit vjetor), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 5.9 miliardë lekë (9.7 % e planifikimit vjetor), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 3.1 miliardë lekë (15.3 % më shume se planifikimi për periudhën).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 24 miliardë lekë, 69.4 miliardë lekë (23.5 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 3.8 miliardë lekë (15.7 %) për interesat, 1.1 miliardë lekë (4.8 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 60 milionë lekë (0.3 %) për subvencione, 8.8 miliardë lekë (36.5%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 1.3 miliardë lekë (5.3 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 3.4 miliardë lekë (14 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 7.8 % (shpenzime personeli), 7.4 % (shpenzime për interesat), 3.5 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 3.8 % (subvencione), 6.8 % (sigurimet shoqërore dhe

shëndetësore), 4.4 % dhe 15.7 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brëndshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 5.3 % të shpenzimeve kapitale të parashikuara vjetore, ndërsa financimi i huaj është 4.8 % e këtij planifikimi vjetor.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2013 ishin rreth 27.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 23.8 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 3.1 miliardë.

Tab - 2 *Të ardhurat e realizuara në Janar 2013*

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 7.9 |
| Tatimi mbi fitimin | 1.4 |
| Taksa doganore | 0.4 |
| Taksat nacionale | 2.2 |
| Akcizat | 2.5 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Defiçiti prej 0.2 miliardë lekë, për periudhën Janar 2013, u mbështet në vlerën 0.9 miliardë lekë nga burime të jashtme pasi një zvogëlim prej 1.1 miliardë lekë të burimeve të brëndshme. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brëndshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Janar 2013, disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 27.7 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 27.9 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin Janar, kontributin kryesorë e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet të cilat kapin shifrën e 23.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 24 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3.9 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | **2013** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | **2013** | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | 2013 | Month |
| **Janar** | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | **1.0** | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.71 | **1.00** | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | **2.7** | January |
| Shkurt | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 1.3 | | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 1.01 | | 1.9 | 4.7 | 4.5 | 0.6 | | February |
| Mars | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.4 | | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | | 1.6 | 4.1 | 4.3 | 1.0 | | March |
| Prill | -0.1 | -0.4 | -0.6 | -0.1 | | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 0.58 | | 1.9 | 3.7 | 4.1 | 1.6 | | April |
| Maj | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.8 | | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 0.32 | | 2.1 | 3.3 | 4.2 | 1.9 | | May |
| Qershor | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.8 | | 0.03 | -0.04 | 0.04 | 0.12 | | 2.3 | 3.2 | 3.9 | 2.2 | | June |
| Korrik | -0.7 | -0.5 | -0.7 | -0.2 | | -0.07 | -0.10 | -0.07 | 0.08 | | 2.2 | 3.4 | 3.6 | 2.7 | | July |
| Gusht | 0.7 | 0.8 | 0.3 | 0.4 | | 0.03 | 0.01 | -0.02 | 0.12 | | 2.2 | 3.5 | 3.1 | 2.8 | | August |
| Shtator | 0.8 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | | 0.11 | 0.09 | 0.02 | 0.13 | | 2.0 | 3.4 | 2.8 | 2.6 | | September |
| Tetor | 0.4 | 0.2 | 0.4 | 0.2 | | 0.14 | 0.10 | 0.06 | 0.14 | | 2.3 | 3.0 | 3.0 | 2.4 | | October |
| Nëntor | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | | 0.16 | 0.11 | 0.06 | 0.14 | | 2.8 | 2.8 | 2.9 | 2.5 | | November |
| Dhjetor | 1.6 | 2.2 | 1.0 | 0.9 | | 0.28 | 0.28 | 0.14 | 0.20 | | 3.7 | 3.4 | 1.7 | **2.4** | | **December** |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i kembimit**

Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 Jan | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | Average of period |
| USD | 94.98 | 103.94 | 104.79 | 108.18 | 104.96 | USD |
| EURO | 132.06 | 137.79 | 139.62 | 139.04 | 139.49 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | In the end of period |
| USD | 95.81 | 104.00 | 104.74 | 105.85 | 103.00 | USD |
| EURO | 137.96 | 138.77 | 139.62 | 139.59 | 139.58 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me baze vjetore (ne lek)**

Annual Interest Rates (in ALL)

| | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ne perqindje | | | | | Janar | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 6.78 | 6.07 | 6.07 | 5.17 | 5.07 | 12-M |
| 6-M | 5.74 | 5.16 | 5.16 | 4.30 | 4.20 | 6-M |
| 3-M | 5.05 | 4.42 | 4.42 | 3.78 | 3.56 | 3-M |
| 1-M | 4.56 | 4.70 | 4.70 | 3.06 | 2.75 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 12.46 | 11.52 | 11.52 | 10.58 | 9.26 | 12-M |
| 6-M | 12.54 | 11.69 | 11.69 | 10.34 | 9.80 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.30 | 5.29 | 5.29 | 5.03 | 5.08 | 3-M |
| 6-M | 7.52 | 6.41 | 6.41 | 5.65 | 6.08 | 6-M |
| 12-M | 9.14 | 7.09 | 7.09 | 6.37 | 6.56 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2013**
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2013

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Janar January | ITEMS |
|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **27,684** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Te ardhura nga ndihmat** | **710** | **Grands** |
| **II.** | **Te ardhura tatimore** | **23,827** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **17,047** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 7,893 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,348 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 2,540 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 2,705 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 2,216 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 345 | Customs Duties |
| **II.2** | **Te ardhura nga Pushteti Vendor** | **862** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Takse mbi Pasurine(ndertesat) | 206 | Property Tax |
| 2 | Takse mbi Biznesin e vogel | 314 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 342 | Local Taxes |
| **II.3** | **Te ardh nga fondet speciale** | **5,918** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 5,529 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 215 | Health insurance |
| 3 | Te ardhura per kompensim ne vlere te pronareve | 174 | Revenues for property compesation |
| **III.** | **Te ardhura Jotatimore** | **3,147** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 700 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,634 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Dividenti | 0 | Divident |
| 4 | Tarifat sherbimeve | 427 | Tariffs on servises |
| 5 | Te tjera | 386 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **27,884** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **23,976** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **5,635** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,861 | Wages |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 774 | Social insurance contributions |
| **I.2** | **Interesat** | **3,755** | **Interest** |
| 1 | Te Brendshme | 3,467 | Domestic |
| 2 | Te Huaja | 288 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **1,139** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **60** | **Subsidies** |
| **I.6** | **Shpenzime per fonde speciale** | **8,753** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 7,000 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 1,753 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit te pronareve | | Expenditures for Owners Compensation |
| **I.7** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | 1,282 | **Local budget expenditure** |
| **I.8** | **Shpenzime te tjera** | **3,352** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 75 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 3,277 | Social assistance |
| 5 | Kompensimi I ish-te perndjekurve politike | | Compansation for ex-political prisioners |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **3,908** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshem | 1,289 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 2,619 | Foreign financed |
| | **DEFIÇITI** | **-200** | **CASH BALANCE** |
| | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **200** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| | **Brendshem** | **-1,123** | **Domestic** |
| | Te ardhura nga privatizimi | 90 | Privatization receipts |
| | Hua-marrje e brendshme | 3,822 | Domestic new borrowing (net) |
| | Nacionale | 3,793 | Other |
| | Lokale | 29 | Foreign |
| | Te tjera | -260 | Other |
| | Depozite e Qeverise ne Banken e Shqiperise | -4,650 | Government deposits into the Central Bank |
| | Te tjera | -385 | Other |
| | Depozita e ISSH dhe ISKSH | -798 | Deposits of Socila and Health insurance |
| | Mjete ne ruajtje | -119 | Preservation stock |
| | Nenhua | 89 | On-Loan Principal |
| | Detyrim ndaj ISSH | 703 | Liabilities to SSI |
| | Te tjera (detyrime te perkohshme) | -260 | Other-Float |
| | **I Huaj** | **1,323** | **Foreign** |
| | Hua afatgjate(e marre) | 2,420 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| | nga e cila Nenhua | 21 | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | -509 | Chang. of stat. Account |
| | Ripagesat | -588 | Repayments |

*Burimi : Ministria e Financave*
* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Dep* *Source : Ministry of Finance*
*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2012

Table of investments 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| Financim i brendshem | 1,289 | Domestic financing |
| *Ne %* | *32.98* | *In %* |
| Financim i huaj | 2,619 | Foreign financing |
| *Ne %* | *67.02* | *In %* |
| Totali | 3,908 | Total |
| *Ne %* | *100* | *In %* |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

## Tab - 6 TE ARDHURAT DOGANORE 2012 (CUSTOMS REVENUES 2012)

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| Takse doganore | 345 | Customs Duties |
| TVSH | 5,776 | V.A.T |
| Akcize | 2,327 | Excises |
| Te tjera | 684 | Others |
| **TOTALI** | **9,132** | **Total** |

## TE ARDHURAT TATIMORE 2012 (TAX REVENUE )

| | | |
|---|---|---|
| TVSH | 2,117 | V.A.T |
| Akciza | 213 | Excises |
| Tatim mbi fitimin | 1,348 | Profit Tax |
| Tatimi mbi te ardhurat personale | 2,705 | Personal income tax |
| Taksa nacionale dhe te tjera | 1,532 | National taxes |
| **TOTALI** | **7,915** | **Total** |
| **TOTALI I PERGJITHSHEM** | **17,047** | **OVERALL TOTAL** |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

Tab - 7

## DEFICITI DHE FINANCIMI PER 2013

The Deficit and Its Financing for 2013

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *Ne milion leke (In million Leks)*

| | Janar January | |
|---|---|---|
| **TE ARDHURAT** | **27,684** | REVENUE |
| **SHPENZIMET** | **27,884** | EXPENDITURES |
| **BILANCI FISKAL** | **-200** | FISCAL BALANCE |
| **FINANCIMI I BILANCIT FISKAL** | **200** | FINANCING |
| **Financimi i brendshem** | **-1,123** | Domestic |
| a. Bono Thesari Neto | 793 | Treasury bills |
| b. Obligacione | 3,000 | Bonds |
| *c. Ndryshimi i gjendjes se arkes* | *-5,448* | Chang.of stat. account |
| Depozita e qeverise ne BSH | -4,650 | Deposit of Government in B.O.A |
| Depozita e ISSH dhe ISKSH | -798 | Deposit of Social & Health Ins. |
| Mjete ne ruajtje | -119 | Non-budget revenues |
| Te ardhura nga privatizimi | 90 | Privatization receipts |
| Te tjera detyrime (te perkohshme) | 532 | Others |
| Huamarrje Brendshme Vendori | 29 | Local Borrowing |
| **Financimi I jashtem** | **1,323** | Foreing |
| a. Hua afatgjate | 2,420 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| nga e cila: nenhua | 21 | |
| b. Ndryshimi I gjendjes se arkes | -509 | Chang. of stat. Account |
| Ripagesat | -588 | Repayments |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

Tab - 8

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

*Ne milion Euro* In millions Euro

| | 3M_I 2011 | 3M_II 2011 | 6M_I 2011 | 3M_I 2012 | 3M_II 2012 | 6M_I 2012 | 3M_III 2012 | 9M_2012 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llogaria korente** | **-212.20** | **-321.90** | **-534.10** | **-253.20** | **-219.80** | **-473.00** | **-198.00** | **-671.00** | **Current Account.** |
| **Bilanci tregetar** | **-408.50** | **-581.40** | **-989.90** | **-465.40** | **-475.50** | **-940.90** | **-540.50** | **-1,481.40** | **Trade Balance.** |
| Eksporti I mallrave fob | 370.60 | 330.80 | 701.40 | 325.80 | 394.20 | 720.00 | 402.50 | 1,122.50 | Merchandise Exports. Fob |
| Importi I mallrave fob | -779.10 | -912.20 | -1,691.30 | -791.20 | -869.70 | -1,660.90 | -943.00 | -2,603.90 | Merchandise Imports. Fob |
| **Bilanci i sherbimeve** | **-17.10** | **-6.20** | **-23.30** | **8.40** | **26.20** | **34.60** | **132.70** | **167.30** | **Services Balance.** |
| Sherbimet Kredi | 312.30 | 376.80 | 689.10 | 293.80 | 381.10 | 674.90 | 578.10 | 1,253.00 | Services Credit |
| Sherbimet Debi | -329.40 | -383.00 | -712.40 | -285.40 | -354.90 | -640.30 | -445.40 | -1,085.70 | Services Debt |
| **Bilanci i te ardhurave** | **5.20** | **5.60** | **10.80** | **-1.90** | **-10.20** | **-12.10** | **20.80** | **8.70** | **Balance of Incomes** |
| Te ardhurat Kredi | 57.20 | 58.60 | 115.80 | 59.70 | 60.90 | 120.60 | 74.90 | 195.50 | Income Credit |
| Te ardhurat Debi | -52.00 | -53.00 | -105.00 | -61.60 | -71.10 | -132.70 | -54.10 | -186.80 | Income Debt |
| **Bilanci i transfertave** | **208.20** | **260.20** | **468.40** | **205.70** | **239.70** | **445.40** | **189.00** | **634.40** | **Balance of Transfers** |
| Transferta private | 206.80 | 253.70 | 460.50 | 202.00 | 236.40 | 438.40 | 185.10 | 623.50 | Private Unrequired Transfers |
| Transfertat shteterore | 1.40 | 6.50 | 7.90 | 3.70 | 3.30 | 7.00 | 3.90 | 10.90 | Offical Unrequired Transfers |
| **Llogaria kapitale** | **65.70** | **31.50** | **97.20** | **12.90** | **43.00** | **55.90** | **9.80** | **65.70** | **Capital Account** |
| **Llogaria financiare** | **164.70** | **168.40** | **333.10** | **245.40** | **129.20** | **374.60** | **166.90** | **541.50** | **Financial Account** |
| Investime direkte | 84.60 | 210.50 | 295.10 | 199.30 | 178.30 | 377.60 | 163.90 | 541.50 | Direct Investment |
| Investime portofoli | 6.20 | -32.50 | -26.30 | -46.70 | 23.10 | -23.60 | -11.50 | -35.10 | Portofolio Investment |
| Kapitale te tjera | 73.90 | -9.20 | 64.70 | 92.80 | -63.50 | 29.30 | 18.40 | 47.70 | Other Capital |
| **Gabime dhe harresa neto** | **-95.40** | **120.40** | **25.00** | **-2.00** | **55.20** | **53.20** | **111.00** | **164.20** | **Net errors and omissions** |
| **Bilanci i pergjithshem** | **-77.10** | **-1.70** | **-78.80** | **3.10** | **7.6** | **10.70** | **89.70** | **100.40** | **Overall Balance** |
| | | | **0.00** | | | | | | |
| Rezervat | 77.10 | 1.70 | 78.80 | -3.20 | -7.50 | -10.70 | -89.70 | -100.40 | Reserve Assets |
| Perdor kred & huash nga FMN | 15.70 | -0.40 | 15.30 | 0.00 | -8.70 | -8.70 | -3.90 | -12.60 | Use of Fund Credit and Loans |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 9** **MJETET VALUTORE NETO**
Net Foreign Assets

| Ne milione leke<br>Fundi i periudhes | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013<br>Janar<br>Jan | Millions of leke<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Mjetet valutore neto | 214,466.7 | 252,827.9 | 255,657.9 | 266540 | 259,567.1 | Net Foreign assets |
| Predendime ndaj jorezidenteve | 236,223.3 | 274,628.2 | 276,475.7 | 288142.1 | 280,833.2 | Claims on non-rezidents |
| Minus: Detyrime ndaj jorezidenteve | 21,756.6 | 21,800.3 | 20,817.8 | 21602.1 | 21,266.1 | Minus: Liabilities to non-residents |
| | | | | | | |
| Mjetet e brendshme | 105,263.2 | 72,244.4 | 84,492.3 | 78858.1 | 69,984.8 | Domestic Assets |
| Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore | 71,369.7 | 57,937.1 | 57,098.0 | 55145.6 | 51,233.8 | |
| Pretendimet ndaj qeverise qendrore | 82,289.4 | 66,928.8 | 67,590.8 | 68057.8 | 68,400.2 | Net Calims on Central Government |
| Minus: Detyrime ndaj qeverise qendrore | 10,919.7 | 8,991.7 | 10,492.8 | 12912.2 | 17,166.4 | Minus: Due to Central Government |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera depozituese | 32,372.6 | 12,535.6 | 25,485.8 | 21800.8 | 16,845.5 | Claims on other depository corporations |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera financiare | - | - | - | - | - | Claims on other financial corporations |
| Pretendime ndaj korporateve jofinanciare publike | - | - | - | - | - | Claims on public non-financial corporations |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera jofinanciare | - | - | - | - | - | Claims on other non-financial corporations |
| Pretendime ndaj sektoreve te tjere rezidente | 1,520.9 | 1,771.7 | 1,908.5 | 1911.7 | 1,905.5 | Claims on other resident sectors |
| Baza Monetare | 284,839.7 | 283,453.5 | 289,809.0 | 297721.9 | 285,395.0 | Monetary Baze |
| Depozita te paperfshira ne parane e gjere | 709.9 | 625.3 | 2,432.0 | 1125.1 | 1,379.0 | Deposits |
| Huate | - | - | - | - | - | Loans |
| Llogari te pagueshme | 720.6 | 797.9 | 901.1 | 1306.1 | 1,323.8 | Other accounts payable |
| Te tjera neto | -6,537.2 | -12,051.3 | -12,984.4 | -14702.6 | -14,681.0 | Other items net |
| Aksione | 39,997.0 | 52,246.7 | 59,992.0 | 59,947.5 | 56,135.0 | Shares and other equity |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 10** **KREDIA PER EKONOMINE**
Credit to Economy

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013<br>Janar<br>Jan | Million of leks<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali I kredise** | **440,397.4** | **483,044.8** | **541,899.9** | 554732.2 | **551,444.8** | **Total Credit** |
| **Kredia per qeverine lokale** | **-** | **-** | **147.20** | 193.9 | **189.70** | **Credits to local Government** |
| Ne leke | - | - | 147.20 | 193.9 | 189.70 | in lek |
| Ne valute | - | - | - | - | - | in Foreingn Currency |
| | - | - | - | - | - | |
| **Kredia per korporatat jofinanciare publike** | **12,056.3** | **9,373.9** | **18,678.5** | 23780.7 | **23,753.7** | **Credits to Public Non-financial Corporations** |
| Ne leke | 6,323.5 | 5,022.9 | 8,446.2 | 18474.3 | 18,401.1 | in lek |
| Ne valute | 5,732.8 | 4,351.0 | 10,232.3 | 5306.4 | 5,352.6 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat jofinanciare private** | **275,479.8** | **315,879.1** | **364,373.9** | 370993 | **369,151.5** | **Credits to other Non-financial Corporations** |
| Ne leke | 70,353.3 | 83,234.9 | 108,321.7 | 121808.7 | 119,665.3 | in lek |
| Ne valute | 205,126.5 | 232,644.2 | 256,052.2 | 249184.3 | 249,486.2 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat e tjera financiare** | **6,032.3** | **8,704.5** | **9,841.9** | 10162.9 | **9,986.5** | **Credits to Other Financial Corporations** |
| Ne leke | 816.3 | 2,957.0 | 3,364.2 | 4031.7 | 3,968.4 | in lek |
| Ne valute | 5,216.0 | 5,747.5 | 6,477.7 | 6131.2 | 6,018.1 | in Foreingn Currency |
| **Pretendime per sektore te tjere rezidente** | **146,829.0** | **149,087.3** | **148,858.4** | 149601.7 | **148,363.4** | **Claims to other Resident Sectors** |
| Ne leke | 62,986.8 | 65,897.5 | 68,499.9 | 70614.1 | 70,231.0 | in lek |
| Ne valute | 83,842.3 | 83,189.8 | 80,358.5 | 78987.6 | 78,132.4 | in Foreingn Currency |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 11** **OFERTA E PARASE**
Money Supply

Mujor-Monthly

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013<br>Janar<br>Jan | Millions of LEK<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Baza monetare** | **228,230.9** | **271,729.2** | **284,839.7** | **283,453.5** | **289,809.5** | **297,721.9** | **285,395.0** | **Base Money** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 4.9 | 19.1 | 4.8 | -0.5 | 5.4 | 2.7 | 0.5 | Y/Y change in % |
| **Paraja jashte korporatave depozituese** | **154,956.2** | **195,808.5** | **209,043.8** | **195,059.0** | **194,923.4** | **192,705.1** | **184,703.5** | **Currency Outside Depository** |
| Ndryshimi vjetor ne % | -5.1 | 26.4 | 6.8 | -6.7 | -0.1 | -1.1 | -1.9 | Y/Y change in % |
| **Depozita** | **602,653.7** | **619,790.4** | **662,425.7** | **785,225** | **875,230** | **930,703** | **928,559.3** | **Deposits** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 19.8 | 2.8 | 6.9 | 18.5 | 10.5 | 6.3 | 6.4 | Y/Y change in % |
| **Agregati M1** | **242,676.0** | **282,853.5** | **284,505.6** | **275,427.3** | **276,898.3** | **281,246.6** | **267,783.0** | **M1 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 0.1 | 16.6 | 0.6 | -3.2 | 0.5 | 1.6 | 1.0 | Y/Y change in % |
| **Agregati M2** | **506,137.5** | **554,908.7** | **578,181.5** | **604,517.3** | **647,007.8** | **669,577.1** | **660,455.2** | **M2 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 6.0 | 9.6 | 4.2 | 4.6 | 7.0 | 3.5 | 2.9 | Y/Y change in % |
| **Agregati M3** | **757,609.9** | **815,598.9** | **871,469.5** | **980,283.9** | **1,070,153.7** | **1,123,407.8** | **1,113,262.8** | **M3 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 13.7 | 7.7 | 6.8 | 12.5 | 9.2 | 5.0 | 4.9 | Y/Y change in % |
| **Burimet e bazes monetare** | | | | | | | | **Monetary Base sources** |
| Mjetet e huaja neto | 170,987.2 | 201,191.1 | 214,466.8 | 252,827.8 | 255,657.9 | 266,540.0 | 259,567.1 | Net foreign assets |
| Mjetet e brendshme neto | 60,112.5 | 85,397.1 | 105,263.2 | 72,244.3 | 84,492.3 | 78,858.1 | 69,984.8 | Domestic assets |
| Pretendimet ndaj qeverise qendrore neto | 57,457.0 | 64,073.6 | 71,369.8 | 57,937.1 | 57,098.1 | 55,145.6 | 51,233.8 | Net Claims on central government |
| Pretendimet ndaj korporatave te tjera depozituese | 1,604.3 | 20,141.9 | 32,372.6 | 12,535.6 | 25,485.8 | 21,800.8 | 16,845.5 | Clains on other depository corporatons |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 12 **DEPOZITAT**
Deposits

| Ne milione leke / Fundi i periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 Janar Jan | Millions of Leks / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Në lekë** | **351,181** | **359,187** | **369,138** | **409,459** | **452,085** | **476,872** | **475,752** | **In national currency** |
| **Depozitat e transferueshme +Depozita me likuiditet të l** | **69,462** | **70,355** | **61,372** | **80,369** | **81,975** | **88,541** | 83,079.6 | **Transferable deposits+Liquid deposits** |
| Qeveria lokale | 478.7 | 482.8 | 478.1 | 948.1 | 1,157.4 | 1,059.7 | 1,089.7 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 11,459.8 | 698.2 | 7,687.7 | 7,134.0 | 7,303.4 | 7,168.0 | 7,193.7 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 557.2 | 6,768.7 | 675.3 | 920.6 | 532.5 | 1,789.2 | 567.8 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 31,857.1 | 33,320.4 | 20,574.7 | 22,505.0 | 20,681.5 | 24,716.6 | 22,346.8 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 25,108.9 | 29,085.2 | 31,956.3 | 48,860.8 | 52,300.1 | 53,807.9 | 51,881.6 | Other resident sectors |
| **Depozita të tjera** | **263,462** | **272,142** | **293,676** | **329,090** | **370,110** | **388,331** | **392,672** | **Other deposits** |
| Qeveria lokale | 206.4 | 17.7 | 8.4 | 55.1 | 109.6 | 19.4 | 17.2 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 2,476.6 | 831.8 | 3,378.4 | 3,054.3 | 2,608.9 | 1,715.4 | 2,555.5 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 300.4 | 1,331.5 | 786.6 | 1,773.4 | 1,423.5 | 2,224.4 | 3,743.4 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 5,777.1 | 9,428.6 | 9,898.3 | 8,316.8 | 11,292.5 | 10,954.1 | 9,775.8 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 254,701.3 | 260,532.8 | 279,604.3 | 315,890.5 | 354,675.1 | 373,417.3 | 376,580.4 | Other resident sectors |
| **Në valutë** | **251,472** | **260,700** | **293,288** | **375,767** | **423,146** | **453,831** | **452,808** | **In foreign currency** |
| Qeveria lokale | 371.5 | 279.5 | 313.0 | 493.0 | 280.5 | 44.5 | 64.8 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 7,963.7 | 2,339.8 | 6,771.0 | 6,201.0 | 5,242.2 | 4,011.2 | 4,172.5 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 1,569.3 | 8,089.6 | 3,672.8 | 8,572.0 | 6,022.3 | 6,303.3 | 6,412.3 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 45,791.4 | 45,922.9 | 39,582.9 | 57,382.9 | 54,418.4 | 46,867.5 | 47,507.5 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 195,776.5 | 204,068.1 | 242,948.4 | 303,117.7 | 357,182.4 | 396,604.2 | 394,650.4 | Other resident sectors |
| **Totali** | **601,597** | **619,107** | **661,626** | **785,225** | **875,230** | **930,703** | **928,559** | **Total** |
| Qeveria lokale | 1,057 | 780 | 799 | 1,496.2 | 1,547.5 | 1,123.6 | 1,172 | Local governments |
| Korporata jofinanciare publike | 21,900 | 3,870 | 17,837 | 16,389.3 | 15,154.5 | 12,894.6 | 13,922 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 2,427 | 16,655 | 5,243 | 11,266.0 | 7,978.3 | 10,316.9 | 10,724 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 83,440 | 88,934 | 70,361 | 88,204.7 | 86,392.4 | 82,538.2 | 79,630 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 493,830 | 509,649 | 568,186 | 667,869.0 | 764,157.6 | 823,829.4 | 823,112 | Other resident sectors |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 13 **BILANCI I PERMBLEDHUR I BSH**
Consolidated BoA Balance sheet

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013<br>Janar<br>Jan | Millions of Lek<br>End of period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | **359,552** | **368,032** | **384,581** | **394,834** | **382,749** | **ASSET** |
| **Total** | **62,644** | **50,480** | **48,572** | **48,288** | **38,648** | **Total** |
| Mbajtjet e SDR | 7,546.1 | 8,126.9 | 8,226.5 | 8,789.7 | 8,379.5 | SDR holdings |
| Arka ne valute | 705.8 | 647.0 | 59.8 | 67.5 | 71.9 | Foreign currency |
| Depozitat | 54,392 | 41,705.7 | 40,286.0 | 39,431.1 | 30,196.9 | Deposits |
| **Letrat me vlere te ndryshme nga aksionet** | **243,143** | **280,301** | **284,210** | **294,007** | **295,972.0** | **Securities other than shares** |
| jorezident | 165,853.4 | 215,901.8 | 219,718.8 | 229,313.1 | 231,633.7 | nonresidents |
| qeveria qendrore | 77,289.4 | 64,399.2 | 64,490.8 | 64,694.1 | 64,338.3 | central government |
| **Huate** | **33,885** | **14,302** | **27,388** | **23,707** | **18,745** | **Loans** |
| Qeveria qendrore | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Central Government |
| Korporata te tjera depozituese | 32,371.7 | 12,534.8 | 25,485.4 | 21,800.2 | 16,844.9 | Other depository corporations |
| Sektore te tjere rezidente | 1,513.5 | 1,767.3 | 1,902.8 | 1,906.5 | 1,900.2 | Other resident secotrs |
| **Derivatet financiare** | **10.7** | **81.4** | **35.3** | **14.2** | **14.6** | **Financial derivatives** |
| **Llogari te arketueshme** | **13,279.2** | **10,748.3** | **11,295.9** | **14,129.2** | **14,833.6** | **Receivable accounts** |
| **Mjetet jofinanciare** | **6,590.9** | **12,119.1** | **13,080.0** | **14,688.0** | **14,535.8** | **Nonfinacial assets** |
| **DETYRIMET** | **359,552** | **368,032** | **384,581** | **394,834** | **382,750** | **LIABILITIES** |
| **Total** | **216,768** | **202,644** | **203,009** | **201,086** | **193,147** | **Total** |
| Para ne qarkullim | 216,767.6 | 202,386.7 | 202,906.6 | 200,898.7 | 193,000.1 | Currency in Circulation |
| Depozitat e perfshira ne parane e gjere | 0.6 | 256.8 | 102.8 | 187.3 | 147.2 | Deposits included in broad money |
| **Depozita te paperfshira ne parane e gjere** | **87,661** | **98,842** | **108,017** | **120,691** | **120,799** | **Deposits excluded from broad money** |
| jorezident | 7,981.6 | 8,440.3 | 8,318.7 | 10,042.9 | 10,026.1 | nonresidents |
| qeveria qendrore | 10,897.5 | 8,966.2 | 10,465.6 | 12,887.1 | 17,145.8 | central government |
| korporata te tjera depozituese | 68,071.5 | 80,810.0 | 88,570.2 | 97,054.7 | 92,666.5 | other depository corporations |
| korporata te tjera jofinanciare | 17.0 | 14.9 | 20.5 | 37.2 | 39.0 | other nonfinancial corporations |
| sektore te tjere rezidente | 692.9 | 610.4 | 641.5 | 669.2 | 921.3 | other resident sectors |
| **Huate** | **1,269** | **5,921** | **4,852** | **3,871** | **3,663** | **Loans** |
| Jorezidentet | 1,269.2 | 5,920.6 | 4,852.0 | 3,870.7 | 3,663.0 | Nonresidents |
| Qeveria qendrore | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Central Government |
| Korporata te tjera depozituese | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Other depository corporations |
| **Llogari te pagueshme** | **6,903.5** | **936.4** | **1,064.3** | **1,680.5** | **1,634.3** | **Other accounts payable** |
| **Alokimi I SDR** | **6,954.1** | **7,439.5** | **7,647.1** | **7,557.9** | **7,371.2** | **SDR allocation** |
| **Aksione dhe insturmenta te tjere** | **39,997** | **52,249.7** | **59,992.0** | **59,947.5** | **56,135.0** | **Shares and other equity** |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*